



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



NR. _____ PROT

TIRANË, MË _____ . _____ . 2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime Rrjeti data 2025 për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard Sha”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32412120-1- rrjeti intranet

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,360,000 (Nëntë milion e treqind e gjashtedhjetë mijë) leke pa tvsh.

Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, është **187,200** (njqind e tetedhjetë e shtatë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH.

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit, Nr. 598 ,datë 12.05.2025, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: “Shërbime Rrjeti data 2025 **për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard Sha”.**

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: : Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë jo më e vogël se 30 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses

te një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, “Për kontratat e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Lidhur me këte pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar për secilin Lot, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësinë e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 10 inxhinierë të diplomuar në fushën e teknologjisë dhe telekomunikacionit).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

❖ Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal

ose kopje e noterizuar: Diplomat universitare ne deget Inxhinieri Telekomunikacioni/Elektronike/Informatike.

Argumentimi: Autoriteti kontraktor e argumenton të nevojshme përfshirjen e 10 inxhinierëve në këtë projekt me arsyetimin që duke marrë në konsideratë numrin e shumtë të pikave, zyrave vendodhjen e tyre të ndryshme gjeografike. Më konkretisht vlerësohet se, inxhinierët nevojiten posaçërisht për të ndjekur projektin në 133 Zyra shërbimi dhe zyrat qendrore.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41/4 e VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

OE duhet te kete ne stafin e tij, punonjesit me certifikimet si me poshte:

- Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) persona të certifikuar CCNA Associate Routing and Switching / Ekuivalent.

Argumentimi: Certifikimi i CCNA (Cisco Certified Network Associate) është një nga certifikatat e nivelit të bashkëpunëtorëve të ofruar nga Cisco tek profesionistët e rrjetëzimit (network). Një ndër arsytet përse është kërkuar specialist i certifikuar CCNA ose ekuivalente, lidhet me faktin se Autoriteti Kontraktor, që i vijnë në ndihmë dhe janë pjesë funksionale e këtij projekti, dhe nga kërkimet në website zyrtare, rezulton se pjesëmarrësit në programin CCNA zgjerojnë aftësitë e tyre në konfigurimin e rrjetit Cisco, monitorimin dhe zgjidhjen e problemeve. Fusha e specialitetit që mbulon certifikata CCNA, janë (network fundamentals, network access, Ip connectivity etj).

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin

- Operatori ekonomik duhet të ketë të 2 Specialiste te certifikuar per Sigurine Kibernetike /ose ekuivalent.

Certifikimi deshmon qe OE ka staf te certifikuar ne nivel sigurie per administrim rrjeti. Gjithashtu duke qene se ne kete procedure kerkohet mbrojtje nga sulmet DDOS eshte e domosdoshme qe OE te disponoje minimalisht nje person pergjegjes per sigurine kibernetike.

Argumentimi: Kërkesa për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE, e cila ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi. Ky shërbim është i rëndësishëm për IG sh.a duke pasur parasysh edhe rëndësinë e vecantë që ka përdorimi i intranetit si infrastrukturë komunikimi ndërmjet entiteve qendrore me ato lokale të IG sh.a. por edhe lidhjet me jashtë IG, për këtë është kërkuar një shërbim i vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë /24 orë dhe në 7 ditë të javës. Kompania është e detyruar të ofrojë shërbim teknik të nevojshëm pranë IG sh.a. dhe për këtë është e nevojshme numri i punonjësve përgjegjës dhe kalifikimet për mirëmbajtjen me efikasitet të kësaj lidhjeje.

Ky kriter mbështetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) inxhinierë për sigurinë e rrjetit ose ekuivalent.

Argumentimi: Dy punonjës të certifikuar për sigurinë e rrjetit sigurojnë mbrojtjen e infrastrukurës dhe të dhenave të organizatës që kalojnë përmes rrjetit për të shmangur dhe parandaluar sulmet. Monitoron dhe analizon trafikun e rrjetit, sigurojnë që të dhenat të mbrohen nga vjedhja dhe nderhyrjet për të ruajtur konfidencialitetin dhe integritetin e tyre. Konfigurojnë, përdorin software dhe protokolle të sigurisë për të mundësuar mbrojtje efektive, si edhe të përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë (GDPR) për ruajtjen e privatesisë.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 2 (dy) teknikë të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.

Për zbatimin korrekt dhe të sigurt të një infrastrukture rrjeti dhe sistemesh të lidhura me shërbime të avancuara të komunikimit, është e nevojshme që operatori ekonomik të angazhojë personel teknik me kualifikime të verifikuara dhe të standardizuara ndërkombëtarisht. SCTE (Society of Cable Telecommunications Engineers) është një organizatë globale që ofron trajnime dhe certifikime të njohura në industrinë e teknologjisë së rrjetit, telekomunikacionit dhe infrastrukurës broadband. Një certifikim SCTE në nivel teknik

Instalimin dhe konfigurimin e rrjeteve broadband, diagnostikimin e problemeve teknike në rrjet dhe pajisje, zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira për performancë dhe siguri. Në rast se certifikimi nuk është i lëshuar nga SCTE, pranohen certifikime ekuivalente nga organizata të tjera ndërkombëtare, për atë kohë sa ato mbulojnë të njëjtat aspekte teknike dhe praktike në fushën e rrjeteve dhe telekomunikacionit. Pranueshmëria e ekuivalencës vlerësohet mbi bazën e Organizatës lëshuese dhe njohjes ndërkombëtare të saj.

Për pikat si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.3 Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig .*
- *Diplomat e arsimit të lartë të kërkuara, origjinale ose të noterizuara/ Vërtetim diplomimi sipas ligjit, Certifikatat përkatëse të kursit apo trajnimit .*
- *Një punonjës mund të ketë më shumë se 1 një certifikim/trajnim.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 10, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së dokumenteve provuese”, si më sipër:

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Personeli i kualifikuar si më sipër është i nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi shërbimet e kërkuara kërkojnë që operatori ekonomik të disponojë staf të kualifikuar dhe specializuar i cili të zbatojë me cilësi, por dhe me garanci kontratën). Një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- 1 **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** certifikatën e menaxhimit të cilësisë së shërbimit ose ekuivalente , që kanë lidhje me objektin e kontratës;
- 2 **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ose ekuivalente në lidhje me objektin e kontratës,
- 3 **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent** : për sistemin e menaxhimit shërbimit të teknologjisë dhe informacionit ose ekuivalente në lidhje me objektin e kontratës.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e

Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** ose ekuivalent : është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilesise të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohej nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipërcituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilesisë. Plotësimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohej se informacioni duhet mbrojtur dhe Kontraktori objekt procedure prokurimi, duhet të nderhyjë në sistemin e brendshëm të AK. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

Përmbushja e standartit **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent** është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve.

Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” ShA. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standartit kompanitë aplikojnë praktikën më të mirë, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

2.3.5 Operatori Ekonomik /Ofruesi i shërbimit duhet të paraqese vërtetim nga AKEP për të vërtetuar prezencën e rrjetit tokesor të OE në të gjitha të gjitha pikat në qytetet në të cilat kërkoher shërbimi.

Argumentim: Për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, Operatori Ekonomik duhet ta vërtetojë duke dorëzuar Autorizimin e Përgjithshëm nga AKEP që përbën kuadrin ligjor, të përcaktuar nga ligji nr. 9918 dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një propozim teknik të shoqëruar me skemat e rrjetit të ofertuesit, për zgjidhjen teknike për ofrimin e shërbimit si dhe planin e back-up për ofrimin e shërbimit, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjën e internetit në site primar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu; mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastrukturës BGP (Border Gateway Protocol), mbrojtje në bazë volumetrike, rrugëzim (routing) të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qëndërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Monitorim 24 orë / 7 ditë dhe suport nga specialistë me eksperiencë në këtë shërbim. Operatori ekonomik duhet të ofrojë mbrojtjen DDoS në disa perimetra sigurie (multi layer DDoS protection në të gjithë perimetrat e sigurisë, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare). Gjithashtu për platformen e përdorur për ofrimin e shërbimit DDoS, operatori ekonomik duhet të provojë duke paraqitur kontratën e blerjes/suportit të platformës respektive.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e propozimit Teknik dhe kontratës së blerjes/suportit të platformës respektive për mbrojtjen DDoS.

Argumentimi : Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe i shërben AK që këto besueshmëri që OE ofertues ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas përcaktimeve të bëra në Termat e Referencës.

Mbrojtja kundër sulmeve DDoS (Distributed Denial of Service) është thelbësore për të siguruar që rrjeti të mbetet funksional dhe të mos ndikohet nga sulmet që synojnë të mbingarkojnë infrastrukturën e tij. Kjo siguron një nivel të lartë të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit, duke mbrojtur interesat e institucionit dhe të dhënat e tij sensitive.

Mbrojtja ndaj sulmeve DDoS (Distributed Denial of Service) është një komponent thelbësor për garantimin e **disponueshmërisë, reziliencës dhe sigurisë së vazhdueshme** të sistemit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Zgjidhjen e detajuar teknike sipas indikatorit të cilësisë të përshkruar në specifikimet teknike bashkëlidhur.
- Bllok-skemën totale të sistemit për zgjidhjen e ofruar dhe teknologjinë që ai përdor.
- Zgjidhjen e detajuar me skemë logjike dhe kontraten përkatëse për ofrimin e shërbimit të mbrojtjes DDOS duke treguar qartësisht edhe scrubbing center ku operatori do të drejtojë trafikun në rast sulmesh.

Argumentimi : Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe i shërben AK që këto besueshmëri që OE ofertues ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, sipas përcaktimeve të bëra në Termat e Referencës. Kërkesa për **zgjidhje të detajuar teknike sipas indikatorëve të cilësisë** është një element kyç për të garantuar që zgjidhja e ofruar është e **përshtatshme, funksionale, e qëndrueshme dhe e verifikueshme**, si dhe për të lehtësuar fazat e zbatimit dhe auditimit teknik pas kontraktimit. Paraqitja e **bllok-skemës së plotë dhe përshkrimit të teknologjisë** është një komponent thelbësor për vlerësimin teknik të ofertës dhe për garantimin që zgjidhja e ofruar është funksionale, e zbatueshme dhe në përputhje me kërkesat specifike të projektit. Përfshirja e një zgjidhjeje të mbrojtjes ndaj DDoS me **skemë logjike dhe scrubbing center të dokumentuar**, jo vetëm që siguron sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve, por është gjithashtu një kërkesë minimale për përputhshmëri me standardet moderne të sigurisë së rrjetit dhe infrastrukturës digjitale.

2.3.8 Referuar sasisë së pritshme për instalim si dhe shpërndarjes gjeografike të vendndodhjes së objekteve të parashikuara për instalim, më poshtë (tabela 1) gjeni grafikun e përllëgaritjes së ditëve të punës të nevojshme për instalimin e sistemeve sipas tipologjive.

Tabela 1

NR	Numri i lidhjes për implementim	Kohëzgjatja e implementimit të shërbimit
1.	13-15 lidhje	1 ditë pune
2.	16-60 lidhje	4 ditë pune
3.	61-105 lidhje	7 ditë pune
4.	>105 lidhje	Max 15 ditë pune

Argumentimi: Përcaktimi i afateve të shpejta për realizimin e lidhjeve në rrjetin e të dhënave bazohet në nevojën urgjente për funksionalitetin e sistemeve të sigurisë, në kushte ku infrastruktura aktuale mungon. Kjo masë është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili lejon përshtatjen e kushteve të kontratës sipas natyrës së shërbimit dhe kërkesave të veçanta teknike, si dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që sanksionon domosdoshmërinë e garantimit të cilësisë dhe funksionalitetit të menjëhershëm të pajisjeve të sigurisë publike.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t'i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektesh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit